

PROGRAMI I TRASPARENCËS

I. HYRJE

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”), Agjencia për Eficencën e Energjisë (në vijim “AEE”) duhet të publikojë Programin e Transparencës (në vijim “PT”) të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”). MIE duhet të publikoj informacion sipas veprimtarisë së tij funksionale si dhe të rishikoj e përditësoj PT në çdo rast të ndryshimit të aktivitetit institucional, kuadrit ligjor rregullator apo çdo elementi tjetër që ka lidhje me transparencën proaktive.

Në PT janë të specifikuar kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t’u bërë publik. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë: i plotë, i saktë, i përditësuar, i thjeshtë në konsultim, i kuptueshëm, lehtësisht i aksesueshëm dhe i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të AEE. Gjithashtu, përpara publikimit të informacionit AEE duhet të vlerësojë nëse ka ndonjë kufizim ligjor për publikim.

Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga AEE.

Në programin e transparencës janë të specifikuar kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t’u bërë publik, mënyra e publikimit, si dhe parashikimet ligjore prej të cilave lind detyrimi për publikim. Në publikimin e informacionit, AEE duhet të mbajnë parasysh interesin e publikut si dhe të mundësojnë aksesimin lehtësisht në informacionin publik.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi Transparencës së Agjencia për Eficencën e Energjisë :

1. “E drejta për informim” është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.

2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: Agjencia për Eficencën e Energjisë ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e Agjencia për Eficencën e Energjisë.

4. Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.

5. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (këtej e tutje KDIMDP)

6. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.

7. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:

- i plotë;
- i saktë;
- i përditësuar;
- i thjeshtë në konsultim;
- i kuptueshëm;
- lehtësisht i aksesueshëm;
- i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, AEE. vendos në dispozicion të publikut në faqen e saj të internetit <http://eficenca.gov.al/> dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Strukturën organizative të AEE;
- Tekstet e plota, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prek publikun e gjerë;
- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të shoqërisë AEE , orarin e punës, emrin dhe kontaktet e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit;
- Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, si dhe dokumente që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- Informacion për shërbimet që shoqëria i jep publikut, informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, raportet e auditimit

nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit si dhe çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik;














- Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e politikave apo ushtrimin e funksioneve të KESH sh.a., një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë.

- Informacion për procedurat e prokurimit, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme

- Informacion për shërbimet që autoriteti i jep publikut, përfshirë standartet për cilësinë e shërbimit, një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për ti përfituar ato, informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik.

- Autoriteti Publik, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje dixhitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë;

IV. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË AGJENCISE PER EFICIENCEN E ENERGIJË

| Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë | Baza ligjore | Dokumenti/Përmbajtja | Afati kohor për publikim | Mënyra e publikimit | Struktura përgjegjëse |
|--|--------------|--|--|---|--|
| Përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të AEE | Neni 7/1/a/d | Struktura organizative  STRUKTURA.pdf Funksionet dhe detyrat e AEE  Detyrat e AEE.pdf | Menjëherë pas miratimit Pas botimit në fl/ zyrtare | Faqja zyrtare www.eficenca.gov.al | Spektori I finances dhe shërbimeve mbështetese |
| Tekstet e plota të konventave, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, të çdo dokumenti politikash, të manualit ose ndonjë dokumenti tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë | Neni 7/1/b | <u>Legjislacion kombëtar</u>  (.pdf)  (.pdf)  (.pdf)  (.pdf)  (.pdf)  (.pdf)  (.pdf)  (.pdf)  (.pdf)  (.pdf)  (.pdf) Rregullorja e Brendshme e Institucionit | Pas botimit në fl/zyrtare Menjëherë pas miratimit të urdhrit nga Ministri/titullari | Faqja zyrtare www.eficenca.gov.al | AEE dhe Institucione te reja |

| | | | | | |
|---|--------------|---|--|---|---|
| | |  Rregullore Nr. 43 datë 06.04.2020 .pdf | | | |
| Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës | Neni 7/1/c/g |  Format Kerkese per info.pdf Email: info@eficenca.gov.al Adresa : Blv. Bajram Curri, Rr: "Viktor Eftimiu", Ndërtesa Nr. 1, Kati V,1022, Tirana, Albania Orari : E Hene – E Enjte 08:00-16:30 , E Premte 08:00-14:00 | Pas miratimit të programit të transparencës Menjëherë në rast ndryshimesh | Faqja zyrtare www.eficenca.gov.al | Koordinatori për të drejtën e informimit |
| Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit | Neni7/1/ç | Koordinatori/Orjon Islamaj E-mail : orjon.islamaj@eficenca.gov.al E-mail : info@eficenca.gov.al Adresa : Blv. Bajram Curri, Rr: "Viktor Eftimiu", Ndërtesa Nr. 1, Kati V,1022, Tirana, Albania Orari : E Hene – E Enjte 08:00-16:30 , E Premte 08:00-14:00 | Pas miratimit të urdhrorit të caktimit të Koordinatorit Menjëherë në rast ndryshimesh | Faqja zyrtare www.eficenca.gov.al | Koordinatori për të drejtën e Informimit |
| Të dhëna për arsimimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime | Neni 7/1/a/d | Struktura e pagave  Struktura e pagave.pdf | Menjëherë pas botimit në fletoren/zyrtare Përditësohet pas çdo akt emërimi | Faqja zyrtare www.eficenca.gov.al | Sektori I finances dhe shërbimeve mbështetëse |
| Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i | Neni7/1/dh | Rezolutë e Kuvendit të Shqipërisë Raporte monitorimi/auditimi Dokumente të tjera që përmbajnë tregues të performancës së AEE | Menjëherë pas publikimit në faqen zyrtare të monitoruesve | | Sektori I finances dhe shërbimeve mbështetëse |

| | | | | | |
|---|-------------|--|---|---|---|
| Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përbëjnë tregues të performancës së autoritetit | | | | | |
| Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike dhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara | Neni 7/1/e | <p><u>Tabelat e buxhetit për shpenzime korrente dhe investime</u></p> <p>Raporte monitorimi financiare</p> | Pas miratimit të ligjit të buxhetit | Faqja zyrtare www.eficenca.gov.al | Sektori I finances dhe shërbimeve mbështetese |
| Çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyrë tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik | Neni 7/1/gj | <p>Ligji nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”</p> <p></p> <p>Ligj_146_2014_30.10.2014.pdf</p> | <p>Në momentin kur kërkohen konsultime me publikun</p> <p>Menjëherë pas miratimit me Urdhër Ministri ”</p> <p>Në mënyrë periodike</p> | Faqja zyrtare www.eficenca.gov.al | Koordinatori për të drejtën e Informimit |
| Një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacioni, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe kategorive të informacionit që bëhet publikë pa pagesë | Neni 7/1/h | <p>Dokumentacioni ne AEE mbahet ne perputhje me ligjin Nr 9154 date 06.11.2003 per arkivat</p> <p></p> <p>Ligj_Nr.9154_datë_6.11.2003_Per_arkivat</p> | | | Sektori Arkivit |
| Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji | Neni 7/1/i | Regjistri i kërkesave/përgjigjeve | Pas miratimit të programit të transparencës | Faqja zyrtare www.eficenca.gov.al | Koordinatori për të drejtën e Informimit |
| Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh | Neni 7/1/k | Certifikata e performances se energjise (CPE) | Pas miratimit nga: AEE | Faqja zyrtare www.eficenca.gov.al | Sektori i auditimeve dhe certifikimeve |

V. PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, Agjencia per Eficencen e Energjise vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit [www.eficenca.gov.al] dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës”.

VI. MONITORIMI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit.

Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës.